



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri: KSC-BC-2019-02

Vendosi: Paneli i përbërë prej një gjykatësi të vetëm
Gjykatësi Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 25 mars 2019

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Version publik i redaktuar i

VENDIMIT

mbi kërkesën për rishikim të një vendimi të Administratores

në lidhje me ndihmën juridike

Parashtruesi

Z. Ruzhdi Saramati

GJYKATËSI I VETËM është ngarkuar me shqyrtimin e kërkesës së parashtruar nga z. Ruzhdi Saramati ("Parashtruesi"), më 23 shkurt 2019 ("Kërkesë për rishikim"),¹ për rishikimin e vendimit të Administratores në lidhje me ndihmën juridike, Ref: KSC/REG/IOR/1632, të datës 18 shkurt 2019 ("Vendim në lidhje me ndihmën juridike")² dhe në vijim jep vendimin e tij.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 29 janar 2019, Parashtruesi i dorëzoi Administratores një kërkesë për ndihmë juridike ("Kërkesa për ndihmë juridike"), së bashku me Formularin e Deklarimit të Mjeteve Financiare dhe Formularin e Dhënies së Pëlqimit.³ Më 18 shkurt 2019, Administratorja nxori vendimin në lidhje me ndihmën juridike për refuzimin e kërkesës për ndihmë juridike.⁴
2. Më 23 shkurt 2019, Parashtruesi dorëzoi kërkesën për rishikim, e cila u mor nga Kryetarja e Dhomave të Specializuara të Kosovës më 25 shkurt 2019.⁵ Më 26 shkurt 2019, u caktua gjykatësi i vetëm për rishikimin e vendimit në lidhje me ndihmën juridike.⁶
3. Më 27 shkurt 2019, gjykatësi i vetëm lëshoi një urdhër për Administratoren për dërgimin e dokumenteve lidhur me vendimin në lidhje me ndihmën juridike si dhe për parashtrimin e përgjigjes ndaj kërkesës për rishikim deri më 7 mars

¹ KSC-BC-2019-02, F00001, Parashtruesi, *Kërkesë për rishikimin e vendimit*, 23 shkurt 2019, publike; Një version i nënshkruar i saj u mor me postë më 12 mars 2019 (KSC-BC-2019-02, F00009/COR, Parashtruesi, *Kërkesë për rishikimin e vendimit*, 22 shkurt 2019).

² KSC-BC-2019-02, F00004, Administratorja, *Parashtrim i Administratores në bazë të urdhrit të gjykatësit të vetëm të 27 shkurtit 2019 me 19 shtojca konfidenciale*, 28 shkurt 2019, Shtojca konfidenciale 4.

³ KSC-BC-2019-02, F00004, Administratorja, *Parashtrim i Administratores në bazë të urdhrit të gjykatësit të vetëm të 27 shkurtit 2019 me 19 shtojca konfidenciale*, 28 shkurt 2019, Shtojcat konfidenciale 1, 2 dhe 3.

⁴ Vendim në lidhje me ndihmën juridike, f. 6.

⁵ DHSK, shpërndarë përmes postës së brendshme elektronike nga Njësia për Administrimin e Gjykatës, 25 shkurt 2019.

⁶ KSC-BC-2019-02, F00002, Kryetarja, *Vendim për caktimin e një gjykatësi të vetëm në përputhje me nenin 33(2) të Ligjit për rishikimin e vendimit të Administratores të datës 18 shkurt 2019 në lidhje me ndihmën juridike*, 26 shkurt 2019, publik.

2019.⁷ Më 4 mars 2019, gjykatësi i vetëm lëshoi urdhër për Administratoren për parashtrimin e përgjigjes deri më 7 mars 2019.⁸

4. Më 28 shkurt 2019, Administratorja dorëzoi dokumentet përkatëse, të përfshira në 19 shtojcat konfidenciale (“Dokumentet e Dorëzuara nga Administratorja të 28 shkurtit 2019”).⁹ Më 6 mars 2019, Administratorja parashtrroi përgjigjen ndaj kërkesës për rishikim (“Përgjigjja e Administratores”).¹⁰

5. Më 7 mars 2019, gjykatësi i vetëm urdhëroi që Parashtruesi të dorëzonte kundërpërgjigje ndaj përgjigjes së Administratores brenda pesë ditësh pune nga marrja e përkthimit të përgjigjes në fjalë në gjuhën shqipe.¹¹ Më 10 mars 2019, Parashtruesi dorëzoi kundërpërgjigjen ndaj përgjigjes së Administratores (“Kundërpërgjigjja e Parashtruesit”).¹² Parashtruesi e mori përkthimin e përgjigjes së Administratores më 13 mars 2019, duke iu dhënë kështu kohë deri më 20 mars 2019 që të bënte parashtrimet kundërpërgjigjëse.¹³ Nga Parashtruesi nuk janë marrë parashtrime të mëtejshme.

6. Më 14 mars 2019, gjykatësi i vetëm urdhëroi Administratoren të dorëzonte parashtrime të mëtejshme për sqarimin e çështjeve ende të pasqaruara.¹⁴ Më 18

⁷ KSC-BC-2019-02, F00003, Gjykatësi i vetëm, *Urdhër Administratores për dërgimin e dokumenteve lidhur me vendimin KSC/REG/IOR/1632*, 27 shkurt 2019, publik.

⁸ KSC-BC-2019-02, F00005, Gjykatësi i vetëm, *Urdhër për Administratoren në lidhje me parashtrimin e përgjigjes*, 4 mars 2019, konfidencial.

⁹ KSC-BC-2019-02, F00004, Administratorja, *Parashtrim i Administratores në bazë të urdhrit të gjykatësit të vetëm të 27 shkurtit 2019 me 19 shtojca konfidenciale*, 28 shkurt 2019, publik me shtojca konfidenciale.

¹⁰ KSC-BC-2019-02, F00006, Administratorja, *Përgjigje ndaj kërkesës për rishikim të vendimit të Administratores të 18 shkurtit 2019 në lidhje me ndihmën juridike*, konfidenciale, 6 mars 2019.

¹¹ KSC-BC-2019-02, F00007, Gjykatësi i vetëm, *Urdhër për Parashtruesin për parashtrimin e kundërpërgjigjes*, 7 mars 2019, publik.

¹² KSC-BC-2019-02, F00008, Parashtruesi, *Kundërpërgjigjja ndaj përgjigjes së Administratores*, publike, 10 mars 2019.

¹³ KSC-BC-2019-02, F00006/sqi, Administratorja, *Përgjigje ndaj kërkesës për rishikim të vendimit të Administratores të 18 shkurtit 2019 në lidhje me ndihmën juridike*, 6 mars 2019, konfidenciale.

¹⁴ KSC-BC-2019-02, F00010, gjykatësi i vetëm, *Urdhër për Administratoren për parashtrime të mëtejshme*, konfidencial, 14 mars 2019.

mars 2019, Administratorja dorëzoi një parashtrim të mëtejshëm, së bashku me një shtojcë konfidenciale (“Parashtrimi i Administratores i 18 marsit 2019”).¹⁵

II. PARASHTRIMET

A. PARASHTRUESI

7. Në kërkesën e tij për rishikim, Parashtruesi argumenton se Administratorja ka gabuar në vlerësimin e gjendjes faktike, ndërkohë që ai i kishte plotësuar të gjitha kushtet për miratimin e ndihmës juridike, sikurse vërtetohet nga provat që ka dorëzuar.¹⁶

8. Më konkretisht, Parashtruesi pretendon se ai ka dorëzuar “të gjitha informacionet e besueshme dhe të vërtetuara” lidhur me tri llogaritë e vetme bankare në përdorim të tij.¹⁷ Ai parashtron se Administratorja ka gabuar në nxjerrjen e përfundimit se ai ka dhënë informacion të pasaktë për llogari të ndryshme bankare dhe vëren se ai veç ka shtuar më vonë një llogari të tretë bankare.¹⁸ Së fundi, ai pretendon se Administratorja ka gabuar në nxjerrjen e përfundimit se ai nuk ka dhënë informacion për automjetin e tij, sepse “nuk është kërkuar nga Administratorja automjeti për t’u deklaruar,” ndërkohë që, pas marrjes së kërkesës prej saj, ai ka dhënë informacion të plotë për të.¹⁹ Mbi këto baza, Parashtruesi kërkon rishikim të kërkesës së tij për ndihmë juridike “nga aspekti jo vetëm formal, por edhe material” mbështetur në dokumentacionin që i është kërkuar dhe të cilin ai e ka dërguar në tërësi.²⁰

¹⁵ KSC-BC-2019-02, F00011, Administratorja, *Parashtrim i mëtejshëm në bazë të Urdhrit të 14 marsit 2019 me 1 shtojcë konfidenciale*, 18 mars 2019.

¹⁶ Kërkesë për rishikim, f. 1-2.

¹⁷ Kërkesë për rishikim, para. 1.

¹⁸ Kërkesë për rishikim, para. 2.

¹⁹ Kërkesë për rishikim, para. 3.

²⁰ Kërkesë për rishikim, f. 3.

9. Në kundërpërgjigjen e tij, Parashtruesi thekson edhe një herë argumentet e mësipërme.²¹ Në veçanti ai vëren se informacioni i dhënë për tri llogaritë bankare është i saktë dhe u përgjigjet plotësisht deklaratave bankare për secilën llogari.²² Së fundi, ai parashtron se Administratorja e ka shqyrtuar dokumentacionin “nga aspekti formal e jo faktiko-juridik e material.”²³

B. ADMINISTRATORJA

10. Në vendimin e saj në lidhje me ndihmën juridike, pasi nxori përfundimin se Parashtruesi nuk i ka mjetet financiare për të kontribuar për përfaqësimin e tij juridik,²⁴ Administratorja megjithatë e refuzoi kërkesën për ndihmë juridike bazuar në përfundimin e saj se Parashtruesi nuk i kishte plotësuar “të gjitha kriteret formale” kur kishte paraqitur kërkesën për ndihmë juridike. Në marrjen e këtij vendimi, ajo vlerësoi se Parashtruesi nuk kishte dhënë informacion të besueshëm dhe të vërtetuar në lidhje me dy llogaritë bankare të deklaruara në Formularin e Dhënies së Pëlqimit dhe se kishte dhënë informacion për një llogari të tretë bankare dhe për automjetin e tij vetëm pas kërkesës së Administratores për ta bërë këtë. Mbi këto baza, ajo konstatoi se kjo vërtetonte që Parashtruesi “nuk ka bashkëpunuar për vlerësimin e varfërisë së tij.” Duke rikujtuar se barra për vërtetimin e varfërisë bie mbi Parashtruesin dhe duke vërejtur se ai “nuk e provoi këtë”, ajo e refuzoi kërkesën e tij për ndihmë juridike.²⁵

11. Në përgjigjen e saj, Administratorja thekson se sistemi i ndihmës juridike bazohet në një drejtpeshim midis, nga njëra anë, së drejtës së personave të varfër për të marrë ndihmë juridike nga Dhomat e Specializuara dhe kërkesës për administrimin efikas të Dhomave të Specializuara, përfshirë edhe

²¹ Kundërpërgjigjja e Parashtruesit, para. 1-2.

²² Kundërpërgjigjja e Parashtruesit, f. 2.

²³ Kundërpërgjigjja e Parashtruesit, f. 3.

²⁴ Vendim në lidhje me ndihmën juridike, f. 5.

²⁵ Vendim në lidhje me ndihmën juridike, f. 6.

miradministrimin financiar të fondeve që i janë besuar asaj, në anën tjetër.²⁶ Duke rikujtuar se barra për vërtetimin e varfërisë bie mbi Parashtruesin,²⁷ ajo vëren se një ndër “parimet themelore” të sistemit të ndihmës juridike është që Zyra e Mbrojtjes të ketë mundësinë të kryejë verifikimet e duhura mbi bazën e të dhënave financiare objektive.²⁸

12. Në këtë drejtim, ajo vëren se informacioni i dhënë nga Parashtruesi nuk ishte konfirmuar prej “dokumentacionit të besueshëm zyrtar në lidhje me mjetet financiare, përfshirë edhe llogaritë bankare.”²⁹ Më veçanërisht, ajo parashtron se dy llogaritë bankare të përmendura në Formularin e Dhënies së Pëlqimit “nuk shoqërohen me dokumentacion të saktë e të plotë.”³⁰ Ajo pretendon se Parashtruesi duhej të kishte dorëzuar “nga një formular të veçantë të dhënies së pëlqimit për çdo llogari bankare” së bashku me të dhënat e kontaktit të bankave përkatëse, sikurse ishin kërkuar nga Zyra e Mbrojtjes.³¹

13. Duke vënë në dukje se demonstrimi i varfërisë “varet nga respektimi prej parashtruesve i dispozitave ligjore përkatëse dhe formaliteteve të hartuara për këtë qëllim, dhe jo nga hamendësimet e Zyrës së Mbrojtjes bazuar në informacion të paplotë, të pasaktë dhe kundërthënës të parashtruesit të kërkesës, gjë që bie ndesh me parimet e miradministrimit financiar,”³² Administratorja nxjerr përfundimin se, si pasojë e paaftësisë së Parashtruesit për të paraqitur dokumentacion të saktë dhe të plotë në lidhje me llogaritë e tij bankare, ai nuk ishte në gjendje të vërtetonte pretendimin e tij në lidhje me varfërinë dhe, për këtë arsye, ajo nuk mundi të bindej se atij i takonte ndihmë juridike.³³

²⁶ Përgjigjja e Administratores, para. 45.

²⁷ Përgjigjja e Administratores, para. 46.

²⁸ Përgjigjja e Administratores, para. 50.

²⁹ Përgjigjja e Administratores, para. 47.

³⁰ Përgjigjja e Administratores, para. 48.

³¹ Përgjigjja e Administratores, para. 20, 49.

³² Përgjigjja e Administratores, para. 51.

³³ Përgjigjja e Administratores, para. 52.

14. Së fundi, pasi thekson se do të “mirëpriste sqarime të mëtejshme në këtë çështje”³⁴ dhe përcakton dokumentet shtesë që duhet të dorëzojë Parashtruesi,³⁵ ajo përfundon duke thënë se, në qoftë se parashtrimet e paraqitura nga Parashtruesi do të jenë “të sakta, të faktuara dhe të plota, në përputhje me rregullat dhe formularët përkatës”, ajo “do ta rishikojë vendimin në lidhje me ndihmën juridike në bazë të rregullës 8(4) të Rregullores së Përkohshme për Ndihmë Juridike.”³⁶ Në vijim, Administratorja përcakton më tej dokumentet që kërkon nga Parashtruesi për të vazhduar me rishikimin e vendimit në lidhje me ndihmën juridike.³⁷

III. LIGJI I ZBATUESHËM

15. Në bazë të nenit 34(7) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, Zyra Administrative përfshin një Zyrë të Mbrojtjes, e cila administron një sistem të ndihmës juridike për përfaqësimin e të akuzuarve të varfër ose pjesërisht të varfër para Dhomave të Specializuara të Kosovës.

16. Në bazë të rregullës 8(1) të Rregullores së Përkohshme për Ndihmën Juridike – Udhëzues Pune mbi Kërkesat për Caktimin e Mbrojtësve dhe Ndihmën Juridike (“RRPNJ”),³⁸ Administratorja merr vendim në lidhje me kërkesën për ndihmë juridike pas përfundimit të vlerësimit të varfërisë në bazë të rregullës 7 të RRPNJ-së.

17. Në bazë të rregullës 5(1) të RRPNJ-së, barra për vërtetimin e varfërisë bie mbi parashtruesin e kërkesës. Në bazë të rregullës 5(3)(f), parashtruesi deklaron se informacioni i dhënë në Formularin e Kërkesës për Ndihmë Juridike dhe në Formularin e Deklarimit të Mjeteve Financiare është i vërtetë dhe i plotë me sa ka

³⁴ Përgjigjja e Administratores, para. 56.

³⁵ Përgjigjja e Administratores, para. 57.

³⁶ Përgjigjja e Administratores, para. 59, khs. gjithashtu para. 56.

³⁷ Parashtrimi i Administratores i 18 marsit 2018, para. 9-10.

³⁸ Dokumentet e Dorëzuara nga Administratorja të 28 shkurtit 2018, Shtojca konfidenciale 7.

dijeni. Së fundi, në bazë të rregullës 5(4), Formulari i Deklarimit të Mjeteve Financiare duhet të përmbajë një varg të dhënash për çështje të ndryshme që kanë rëndësi për kryerjen e vlerësimit të varfërisë.

18. Në bazë të rregullës 8(4) të RRPNJ-së, Administratorja mund t'i rishikojë vendimet *proprio motu* në përputhje me rregullën 8 kur vendimet ndikohen në mënyrë të konsiderueshme nga një ndryshim në rrethana.

19. Në bazë të rregullës 11 të RRPNJ-së, çdo vendim sipas RRPNJ-së mund t'i nënshtrohet rishikimit me kërkesë të të dyshuarit ose të akuzuarit, ndër të tjera, nga një gjykatës i vetëm i caktuar për atë qëllim nga Kryetarja.

IV. DISKUTIM

A. STANDARDI I RISHIKIMIT DHE MASA NDREQËSE

20. Aktet normative evropiane dhe ndërkombëtare që kanë të bëjnë me çështje të ndihmës juridike parashohin vendosjen e masave ndreqëse të përshtatshme dhe efektive në rast të shkeljes së të drejtës së një personi për ndihmë juridike.³⁹ Institucione gjyqësore ndërkombëtare kanë pranuar më herët se ekziston nevoja për përcaktimin dhe shtjellimin e standardeve të zbatueshme në lidhje me këto masa ndreqëse. Standardet e hartuara për këtë qëllim në TPNJ⁴⁰ dhe GJPN,⁴¹ si

³⁹ Directive (EU) 2016/1919 of the European Parliament and of the Council of 26 October 2016 on legal aid for suspects and accused persons in criminal proceedings and for requested persons in European arrest warrant proceedings/Direktiva 2016/1919 (BE) e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 tetor 2016 mbi ndihmën juridike për personat e dyshuar dhe të akuzuar në procedura penale dhe për personat e kërkuar në procedurat evropiane për urdhrat e arrestit, Parathënie (27), neni 8; UN Principles and Guidelines on Access to Legal Aid in Criminal Justice Systems, UNGA Resolution A/RES/67/187, 20 December 2012, Principle 9/Parime dhe Udhëzime të KB-së mbi qasjen në ndihmën juridike në sistemet e drejtësisë penale, Rezolutë e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara A/RES/67/187, 20 dhjetor 2012, parimi 9.

⁴⁰ P.sh., ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Kvočka et al./Prokurori kundër Kvočka et al*, Case No./Çështja nr. IT-98-30/1-A, Dhoma e Apelit, *Decision on Review of Registrar's Decision to Withdraw Legal Aid from Zoran Žigić/Vendim mbi rishikimin e vendimit të Administratorit për t'i anuluar ndihmën juridike Zoran Zhigiqit*, 7 shkurt 2003, para. 12-14.

⁴¹ P.sh., ICC/GJPN, *The Prosecutor v. Katanga and Ngudjolo Chui/Prokurori kundër Katanga dhe Ngudjolo Chui*, Case No./Çështja nr. ICC-01/04-01/07-3277, Dhoma gjyqësore, *Decision on Urgent Requests by the Legal Representative of Victims for Review of Registrar's Decision of 3 April 2012 regarding*

edhe standardet e përgjithshme për rishikimin gjyqësor të vendimeve administrative në Tribunalin e Kombeve të Bashkuara për Mosmarrëveshjet,⁴² Tribunalin e Apelit të Kombeve të Bashkuara⁴³ dhe Tribunalin Administrativ të ONP-së⁴⁴ demonstrojnë autoritetin e secilit institucion gjyqësor për të përcaktuar dhe qartësuar standardet e zbatueshme në rishikimet e veta gjyqësore.

21. Kërkesa aktuale për rishikim është e para kërkesë e paraqitur para një gjykatësi të vetëm në pajtim me rregullën 11 të RRPNJ-së. Duke qenë se RRPNJ-ja nuk përmend asgjë për standardin që duhet zbatuar në rastin e këtyre rishikimeve, është thelbësore që për këtë qëllim, si dhe në lidhje me çdo rishikim tjetër të ardhshëm të vendimeve të Administratores në bazë të RRPNJ-së, të përcaktohet një standard i tillë.

22. Duke mbajtur parasysh standardin e brendshëm të zbatuar nga gjykatësi për apelet e punonjësve në pajtim me rregullën 10(1) të Procedurës për Apelet e Punonjësve të DHSK-së, si dhe standardin e jashtëm që zbatohet në Tribunalët e Apelit të Kombeve të Bashkuara në bazë të nenit 2(1) të Statutit të Tribunalit të Apelit të Kombeve të Bashkuara, gjykatësi i vetëm ka kompetencë të pranojë kërkesë për rishikimin e një vendimi administrativ të Administratores dhe të lëshojë vendim në lidhje me të në përputhje me RRPNJ-në, nëse Parashtruesi në kërkesën e tij pretendon se Administratorja:

Legal Aid /Vendim mbi kërkesat urgjente të përfaqësuesit juridik të viktimave për rishikimin e vendimit të Administratorit të 3 prillit 2012 në lidhje me ndihmën juridike, 23 prill 2012, para. 8-9.

⁴² Krahaso p.sh., UNAT/TAKB, *Sanwidi v. Secretary General*/ Sanwidi kundër Sekretarit të Përgjithshëm, Aktgjykim nr. 2010-UNAT-084, 27 tetor 2010, para. 40, 42; *Abbassi v. Secretary General*/ Abbassi kundër Sekretarit të Përgjithshëm, Aktgjykim nr. 2011-UNAT-110, 11 mars 2011, para. 23.

⁴³ Neni 2(1) i Statutit të Gjykatës së Apelit të Kombeve të Bashkuara (UNAT); shtjelluar më tej në p.sh., UNAT/TAKB, *Tsoneva v. Secretary General*/Tsoneva kundër Sekretarit të Përgjithshëm, Aktgjykim nr. 2010-UNAT-045, 1 korrik 2010, para. 12; *Abbassi v. Secretary General*/Abbassi kundër Sekretarit të Përgjithshëm, Aktgjykim nr. 2011-UNAT-110, 11 mars 2011, para. 26; *Gehr v. Secretary General*/ Gehr kundër Sekretarit të Përgjithshëm, Aktgjykim nr. 2012-UNAT-234, 29 qershor 2012, para. 47.

⁴⁴ P.sh., ILOAT/GJAONP, Në *Re Louis*, Aktgjykim nr. 1131, 3 korrik 1991, para. 5; *O v. IAEA*/O kundër ANEA, Aktgjykim nr. 2752, 9 korrik 2008, para. 15; *G (No. 2) v. ITER Organisation*/G. (nr.2) kundër Organizatës RETN, Aktgjykim nr. 3768, 8 shkurt 2017, para. 4; *S. v. ICGEB*/S kundër QNIGJB, Aktgjykim nr. 3912, 24 janar 2018, para. 12.

- a) ka tejkaluar përgjegjësitë ose kompetencat e veta;
- b) nuk ka ushtruar përgjegjësitë e veta;
- c) ka gabuar në lidhje me një çështje ligjore;
- d) ka bërë një gabim në procedurë, i cili ka ndikuar në vendimin e marrë për çështjen; ose
- e) ka gabuar në një çështje fakti, duke çuar në marrjen e një vendimi qartësisht të paarsyeshëm.

23. Gjithashtu, si dhe duke mbajtur parasysh standardin e brendshëm të zbatuar nga gjykatësi i lartë për apelet e punonjësve në bazë të rregullës 25(2) të Procedurës për Apelet e Punonjësve të DHSK-së, si dhe standardin e jashtëm të zbatuar nga Tribunalët e Apelit të Kombeve të Bashkuara në përputhje me nenin 2(3) të Statutit të Tribunalit të Kombeve të Bashkuara, gjykatësi i vetëm mund të lërë në fuqi, të rrëzojë, ose të kthejë për rishikim një vendim administrativ të Administratorit.

B. ARSYET

24. Ndonëse bën parashtrime në lidhje me gabime të pretenduara të Administratores, Parashtruesi nuk i kategorizon qartë këto gabime. Duke pasur parasysh se standardi i rishikimit është përcaktuar vetëm në këtë vendim, gabimet e pretenduara nga Parashtruesi do të kategorizohen dhe analizohen në përputhje me standardin e mësipërm.

25. Vendimi i Administratores për refuzimin e kërkesës për ndihmë juridike bazohet në Arsyet e mëposhtme:⁴⁵

- a) Arsyeya 1: Parashtruesi nuk paraqiti informacion të besueshëm dhe të faktuar për dy llogaritë bankare të deklaruara në Formularin e Deklarimit të Mjeteve Financiare dhe në Formularin e Dhënies së Pëlqimit (“dy llogaritë bankare”), edhe pasi iu kërkua katër herë ta bënte këtë;

⁴⁵ Vendim në lidhje me ndihmën juridike, f. 6.

- b) Arsyeya 2: Parashtruesi e informoi Zyrën e Mbrojtjes për ekzistencën e llogarive të tjera bankare vetëm pas kërkesave të mëtejshme nga Zyra e Mbrojtjes; dhe
- c) Arsyeya 3: Parashtruesi nuk dha informacion për automjetin e tij në Formularin e Deklarimit të Mjeteve Financiare; ai e dha këtë informacion vetëm pasi iu kërkua nga Zyra e Mbrojtjes.

26. Parashtruesi bën këto parashtrime në lidhje me arsyet e mësipërme:

- a) Në lidhje me Arsyen 1: Parashtruesi ka dorëzuar “të gjitha informacionet e besueshme dhe të vërtetuara” në lidhje me dy llogaritë bankare;⁴⁶ dhe rrjedhimisht konsiderohet që Parashtruesi argumenton se Administratorja ka kryer një gabim fakti, kur ka vendosur ndryshe;
- b) Në lidhje me Arsyen 2: Parashtruesi “vetëm ka shtuar edhe llogarinë e tretë bankare [në dy llogaritë bankare]” dhe ka paraqitur “të gjithë informacionet e besueshme dhe të vërtetuara lidhur me [llogarinë e tretë bankare];”⁴⁷ rrjedhimisht konsiderohet që Parashtruesi argumenton se Administratorja ka kryer gabim ligjor kur e refuzoi këtë informacion mbi bazën se u dorëzua vetëm pasi u kërkua nga Zyra e Mbrojtjes; dhe
- c) Në lidhje me Arsyen 3: Parashtruesi “në kërkesën e Administratores [...] plotësisht i ka dërguar informacionet për automjetin posedues;”⁴⁸ rrjedhimisht konsiderohet që Parashtruesi argumenton se Administratorja ka bërë gabim ligjor kur e refuzoi këtë informacion mbi bazën se u dorëzua vetëm pasi u kërkua nga Zyra e Mbrojtjes.

27. Duke qenë se Arsyet 2 dhe 3 kanë të bëjnë me kohën e dhënies së informacionit nga Parashtruesi, ato do të shqyrtohen të parat me qëllim që ky vendim t’i përmbahet kronologjisë procedurale. Gjithashtu, duke qenë se Arsyet 2 dhe 3 janë në përgjithësi identike, ato do të vlerësohen bashkërisht. Arsyeya 1, e cila ka të bëjë me përmbajtjen e informacionit të dhënë, do të vlerësohet në një hap të dytë.

1. Gabimet e pretenduara ligjore

⁴⁶ Kërkesë për rishikim, para. 1; khs. gjithashtu Kundërpërgjigjja e Parashtruesit, f. 2.

⁴⁷ Kërkesë për rishikim, para. 2; Kundërpërgjigjja e Parashtruesit, f. 2.

⁴⁸ Kërkesë për rishikim, para. 3; khs. gjithashtu Kundërpërgjigjja e Parashtruesit, f. 3.

28. Refuzimin e kërkesës për ndihmë juridike Administratorja e bazon, ndër të tjera, në Arsyet 2 dhe 3.⁴⁹ Në lidhje me këtë, Parashtruesi argumenton se ai “ka shtuar një llogari të tretë bankare,” dhe se “në kërkesën e Administratores [...], plotësisht i ka dërguar informacionet për automjetin posedues.”⁵⁰ Rrjedhimisht konsiderohet që Parashtruesi nxjerr përfundimin se konstatimet e Administratores përbëjnë gabim ligjor.

29. Fakti se Parashtruesi në fillim përmendi vetëm dy llogari bankare në Formularin e Dhënies së Pëlqimit dhe nuk përmendi asnjë llogari bankare apo automjet në Formularin e Deklarimit të Mjeteve Financiare, nuk kundërshtohet.⁵¹ Në vijim, Zyra e Mbrojtjes i kërkoi Parashtruesit të dërgonte deklaratat bankare për çfarëdo llogarie tjetër bankare në emër të tij, si dhe informacion për ndonjë automjet që kishte në posedim.⁵² Në përputhje me këtë, Parashtruesi i dorëzoi Zyrës së Mbrojtjes një kopje të vërtetimit të regjistrimit të një automjeti në pronësi të tij,⁵³ si dhe kopje të deklaratave të tij bankare që prej 1 janarit 2018, për llogarinë bankare në [REDAKTIM] me numër [REDAKTIM].⁵⁴ Pas një kërkesë të mëtejshme,⁵⁵ Parashtruesi i paraqiti Zyrës së Mbrojtjes informacion për vlerën e tregut të automjetit, me shënimin që ai nuk e kishte informuar më parë Zyrën e Mbrojtjes për të sepse automjeti ende nuk ishte shitur.⁵⁶

⁴⁹ Vendim në lidhje me ndihmën juridike, f. 6, sikurse pasqyrohet në para. 25 b) dhe c) më lart.

⁵⁰ Kërkesë për rishikim, para. 2-3; khs. gjithashtu Kundërpërgjigjja e Parashtruesit, f. 2-3.

⁵¹ Dokumentet e Dorëzuara nga Administratorja të 28 shkurtit 2019, Shtojca konfidenciale 3, f. 5; Shtojca konfidenciale 2, f. 46, 49 (29 janar 2019).

⁵² Dokumentet e Dorëzuara nga Administratorja të 28 shkurtit 2019, Shtojca konfidenciale 10, f. 8 (31 janar 2019).

⁵³ Dokumentet e Dorëzuara nga Administratorja të 28 shkurtit 2019, Shtojca konfidenciale 11, f. 19 (5 shkurt 2019).

⁵⁴ Dokumentet e Dorëzuara nga Administratorja të 28 shkurtit 2019, Shtojca konfidenciale 13 (11 shkurt 2019).

⁵⁵ Dokumentet e Dorëzuara nga Administratorja të 28 shkurtit 2019, Shtojca konfidenciale 14, f. 6 (11 shkurt 2019).

⁵⁶ Dokumentet e Dorëzuara nga Administratorja të 28 shkurtit 2019, Shtojca konfidenciale 15, f. 13-14 (13 shkurt 2019).

30. Administratorja nuk e vë në dyshim plotësinë apo saktësinë e informacionit të dhënë nga Parashtruesi në lidhje me llogarinë e tretë bankare apo automjetin⁵⁷. Administratorja e bazon vendimin e saj për refuzimin e kërkesës për ndihmë juridike mbi faktin se informacioni i lartpërmendur nuk u dha që në fillim, por vetëm pas kërkesave vijuese të Zyrës së Mbrojtjes.⁵⁸

31. RRPNJ-ja nuk i ofron Administratores bazë ligjore që të refuzojë kërkesa për ndihmë juridike për arsyen e vetme se informacioni përkatës nuk është dhënë që në fillim. Në mungesë të një ndikimi faktik të informacionit të dhënë më vonë mbi vlerësimin e varfërisë, Administratorja nuk mund ta bazojë refuzimin e kërkesës për ndihmë juridike thjesht në faktin se Parashtruesi e ka dhënë këtë informacion vetëm pasi i është kërkuar.

32. Megjithëse vërehet se rregulla 5(3)(e)(2) e RRPNJ-së përcakton detyrimin e Parashtruesit për *kthimin* e shpenzimeve të ndihmës juridike nëse ka dhënë informacion të rremë, ose qëllimisht nuk ka paraqitur informacione që lidhen me vlerësimin e varfërisë, formulimi i kësaj dispozite bën të qartë se ajo zbatohet vetëm në rastet e kthimit të shpenzimeve dhe jo për vendimin fillestar të Administratores në lidhje me kërkesën për ndihmë juridike.

33. Gjithashtu është marrë parasysh si duhet edhe deklarata vërtetuese që përfshihet në Formularin e Kërkesës për Ndihmë Juridike përmes së cilës Parashtruesi duhet të konfirmojë se e ka të qartë se:

Çdo mosdhënie informacioni e qëllimshme apo nga neglizhenca e vetëdijshme në Deklarimin e Mjeteve Financiare, apo në çfarëdo dokumenti tjetër të dorëzuar dhe çdo mosbashkëpunim me procesin e vlerësimit të mungesës së

⁵⁷ Konstatohet se Administratorja ka parashtruar se ajo do ta rishikojë vendimin në lidhje me ndihmën juridike vetëm mbi bazën e informacioneve nga [REDAKTIM] dhe [REDAKTIM] në lidhje me dy llogaritë bankare dhe sipas saj nuk është e detyrueshme paraqitja e një Formulari shtesë të Dhënies së Pëlqimit në lidhje me llogarinë e tretë (Përgjigjja e Administratores, para. 57; Parashtrimi i Administratores i 18 marsit 2019, para. 9-10).

⁵⁸ Vendim në lidhje me ndihmën juridike, f. 6.

mjeteve financiare, mund të sjellë si pasojë mosmiratimin [...] e ndihmës juridike [...].⁵⁹

Sidoqoftë, RRPNJ-ja nuk përcakton shprehimisht mundësinë e një mase të tillë dhe kjo mungesë e bazës ligjore nuk mund të ndreqet thjesht me përfshirjen e këtij paragrafi në Formularin e Kërkesës për Ndhmë Juridike. Për të garantuar parashikueshmërinë dhe përdorueshmërinë e RRPNJ-së për çdo parashtrues, duhen përmbushur kriteret e vlerësimit të varfërisë të përcaktuar në të. Vetëm nënshkrimi i një formulari nga parashtruesi nuk mund të krijojë një arsye për refuzimin e ndihmës juridike, nëse në të njëjtën kohë kjo arsye nuk është përcaktuar në RRPNJ.

34. Ndonëse është krejt e qartë se sipas rregullës 5(1) të RRPNJ-së barra për vërtetimin e varfërisë bie mbi parashtruesin, duhet marrë gjithashtu parasysh fakti se informacioni që parashtruesi duhet t'i dorëzojë Administratorit sipas rregullës 5(4) të RRPNJ-së, është mjaft i gjerë. Mbledhja e një informacioni të tillë, veçanërisht brenda një kohe të shkurtër, mund të jetë mjaft e vështirë kur personi përkatës nuk i njeh procedurat administrative të këtij lloji. Për këtë arsye, është e parashikueshme që për sqarimin e çështjeve mund të nevojiten komunikime të mëtejshme midis Zyrës së Mbrojtjes dhe parashtruesit.

35. Për rastin në fjalë, komunikimet e detajuara midis Zyrës së Mbrojtjes dhe Parashtruesit tregojnë se vlerësimi i varfërisë është duke u kryer në frymën e dialogut dhe në kontekstin e këtij dialogu Zyra e Mbrojtjes kërkoi të dhëna të mëtejshme nga Parashtruesi kur informacioni i dhënë fillimisht ishte i paqartë, ose dukej i paplotë. Kërkesa të tilla vijuese kanë kuptim vetëm nëse Administratorja e shfrytëzon këtë informacion që i jepet për të bërë vlerësimin e varfërisë dhe jo për refuzimin e kërkesës për ndihmë juridike me arsyetimin se ky informacion është dhënë më vonë.

⁵⁹ Khs. Dokumentet e Dorëzuara nga Administratorja të 28 shkurtit 2019, Shtojca konfidenciale 1, f. 6, para. 5.

36. Duke refuzuar kërkesën për ndihmë juridike me arsyetimin se informacioni (i cili nuk kishte asnjë ndikim mbi vlerësimin e varfërisë), nuk u dha që në fillim nga Parashtruesi, por vetëm më pas kur iu kërkua, Administratorja ka bërë gabim ligjor duke qenë se RRPNJ-ja nuk ofron bazë ligjore për një refuzim të tillë.

37. Rrjedhimisht, Administratorja nuk mund të refuzonte kërkesën e Parashtruesit për ndihmë juridike duke u bazuar mbi faktin se informacioni përkatës nuk u dha që në fillim.

2. Gabim i pretenduar fakti

38. Gjithashtu, Administratorja e bazon refuzimin e kërkesës për ndihmë juridike, ndër të tjera, në Arsyen 1, gjegjësisht në përfundimin e saj se Parashtruesi nuk dorëzoi informacion të besueshëm dhe të faktuar në lidhje me dy llogaritë bankare.⁶⁰ Nga ana e tij, Parashtruesi deklaroi se ai dorëzoi “të gjithë informacionin e besueshëm dhe të vërtetuar” në lidhje me dy llogaritë bankare dhe rrjedhimisht arrin në përfundimin se konstatimet e Administratores janë gabime fakti që rezultojnë në një vendim qartazi të paarsyeshëm.⁶¹

(a) Gabim fakti

39. Sipas rregullës 5(3)(f) të RRPNJ-së, Parashtruesi duhet të deklarojë se informacioni i dorëzuar prej tij është “i vërtetë dhe i plotë me sa ka dijeni [ai].”⁶² Ky standard i përcaktuar shprehimisht në RRPNJ është i vetmi ku mund të bazohet Administratorja për vlerësimin nëse Parashtruesi ka dorëzuar “informacion të besueshëm dhe të faktuar” në lidhje me dy llogaritë bankare.

⁶⁰ Vendim në lidhje me ndihmën juridike, f. 6, sikurse pasqyrohet në para. 25 a) më lart.

⁶¹ Kërkesë për rishikim, para 1; Khs. gjithashtu Kundërpërgjigja e Parashtruesit, f. 2-3.

⁶² Khs. gjithashtu Dokumentet e Dorëzuara nga Administratorja të 28 shkurtit 2019, Shtojca konfidenciale 2, f. 57.

40. Në lidhje me këtë, ka gjithashtu rëndësi të kujtohen komunikimet midis Zyrës së Mbrojtjes dhe Parashtruesit në të cilat u sqarua çfarë informacioni i kërkohej Parashtruesit dhe si rrjedhojë, pashmangshmërisht ndikuan në vlerësim e vetë Parashtruesit se çfarë përbënte “[informacion] të vërtetë dhe të plotë me sa ka dijeni [ai].”

41. Sa i përket analizës së fakteve të një çështjeje, Administratores i jepet përparësia e duhur në përcaktimin e fakteve dhe konstatimi për gabim fakti bëhet vetëm nëse Administratorja ka marrë parasysh çështje të parëndësishme, ose ka anashkaluar çështje me rëndësi që i janë paraqitur nga Parashtruesi.⁶³ Gjithashtu, do të mbahen parasysh edhe qasje të institucioneve të tjera të ngjashme për mosndryshimin e vendimit, përveç nëse, ndër të tjera, nuk janë marrë parasysh fakte thelbësore, ose prej provave faktike është nxjerrë një përfundim qartazi i gabuar.⁶⁴

(i) Dokumentet e kërkuara nga Administratorja

42. Në fillim, Zyra e Mbrojtjes i dërgoi një mesazh elektronik mbrojtësit të Parashtruesit ku ndër të tjera sqaronte hapat formalë përkatës që duheshin ndërmarrë për kërkesën për ndihmë juridike, të cilit i bashkëngjiti Formularin e Kërkesës për Ndihmë Juridike, Formularin e Deklarimit të Mjeteve Financiare dhe Formularin e Dhënies së Pëlqimit.⁶⁵ Në lidhje me formularin e tretë, mbrojtësit iu shpjegua se Parashtruesi duhej të plotësonte nga një formular të veçantë “për çdo institucion financiar/bankar veçazi; gjithashtu edhe nga një formular të veçantë

⁶³ Khs. UNAT/TAKB, *Gehr v. Secretary General*, Aktgjykim nr. 2012-UNAT-234, 29 qershor 2012, para. 47.

⁶⁴ Khs. ILOAT/TAONP, *In Re Louis*, Aktgjykim nr. 1131, 3 korrik 1991, para. 5; *O v. IAEA/O kundër ANEA-s*, Aktgjykim nr. 2752, 9 korrik 2008, para. 15, me referenca të mëtejshme; *D. v. WHO/D kundër OBSH-së*, Aktgjykim nr. 3582, 3 shkurt 2016, para. 6.

⁶⁵ Vendim në lidhje me ndihmën juridike, f. 1; Parashtrimi i Administratores i 18 marsit 2019, para. 4 dhe Shtojca konfidenciale 1 (23 janar 2019).

me të dhëna për çdo llogari bankare brenda të njëjtit institucion.”⁶⁶ Parashtruesi dorëzoi versione të nënshkruara, ndër të tjera, të Formularit të Dhënies së Pëlqimit në të cilin ai përmendte “[REDAKTIM] – [REDAKTIM] [...] numri/numrat e llogarisë: [REDAKTIM] dhe [REDAKTIM] nr. [REDAKTIM].”⁶⁷

43. Në vijim, Zyra e Mbrojtjes i dërgoi mbrojtësit të Parashtruesit një mesazh elektronik ku i kërkonte informacion plotësues (“Email i Zyrës së Mbrojtjes”).⁶⁸ Në lidhje me Formularin e Dhënies së Pëlqimit dhe duke iu referuar llogarisë bankare në [REDAKTIM], Zyra e Mbrojtjes vërejtë se mungonin të dhënat e kontaktit për bankën. Gjithashtu Zyra e Mbrojtjes vërejtë përmendjen e llogarisë në [REDAKTIM], “për të cilën [Parashtruesi] duhej të kishte dorëzuar një Formular të veçantë të Dhënies së Pëlqimit.”⁶⁹

44. Sidoqoftë, është e rëndësishme të theksohet se Zyra e Mbrojtjes arriti në përfundimin se “për shkak të kohës relativisht të shkurtër të disponueshme [...] për marrjen e një vendimi të bazuar në informacion në lidhje me kërkesën për ndihmë juridike, [Zyra e Mbrojtjes] i kërkon [Parashtruesit] nëse mund të dorëzojë informacionin vijues: a) gjendjen aktuale në llogaritë [e tij] bankare në [REDAKTIM] dhe [REDAKTIM] dhe kopje të deklaratave bankare për të dy llogaritë që prej 1 janarit 2018 [...]”⁷⁰

⁶⁶ Parashtrimi i Administratores i 18 marsit 2019, Shtojca konfidenciale 1, f. 7 (23 janar 2019).

⁶⁷ Dokumentet e Dorëzuara nga Administratorja të 28 shkurtit 2019, Shtojca konfidenciale 3, f. 5 (29 janar 2019).

⁶⁸ Dokumentet e Dorëzuara nga Administratorja të 28 shkurtit 2019, Shtojca konfidenciale 10 (31 janar 2019).

⁶⁹ Dokumentet e Dorëzuara nga Administratorja më 28 shkurt 2019, Shtojca konfidenciale 10, f. 8 (31 janar 2019); përkthimi fillestar i mesazhit elektronik të Zyrës së Mbrojtjes i mundësuar nga Administratorja ku thuhej se Parashtruesi “**duhet**” të dorëzonte Formularë të veçantë të Dhënies së Pëlqimit (Khs. Dokumentet e Dorëzuara nga Administratorja të 28 shkurtit 2019, Shtojca konfidenciale 10, f. 8), më pas u korrigjua (khs. Parashtrimi i Administratores i 18 marsit 2019, para. 6, poshtëshënimi 7).

⁷⁰ Dokumentet e Dorëzuara nga Administratorja të 28 shkurtit 2019, Shtojca konfidenciale 10, f. 8 (31 janar 2019).

45. Shqyrtimi i komunikimeve të mëtejshme të Zyrës së Mbrojtjes nuk tregon se është kërkuar informacion tjetër veç gjendjes së dy llogarive bankare të Parashtruesit dhe deklaratave bankare që nga 1 janari 2018.⁷¹

46. Pra, megjithëse është marrë parasysh se faktikisht Administratorja kërkoi Formularë të veçantë të Dhënies së Pëlqimit për secilën llogari bankare që në fillim,⁷² kjo kërkesë fillestare duhet vlerësuar mbështetur në komunikimet e mëtejshme me Parashtruesin. Në veçanti, në mesazhin e vet elektronik, Zyra e Mbrojtjes sqaroi se, duke pasur parasysh urgjencën e rrethanave, pavarësisht se fillimisht ishin kërkuar Formularë të Dhënies së Pëlqimit për secilën llogari bankare veç e veç, informacioni që kërkohej duhej të kufizohej vetëm në gjendjen aktuale në dy llogaritë bankare si edhe në deklaratat bankare që prej 1 janarit 2018; komunikimet e mëtejshme midis Zyrës së Mbrojtjes dhe Parashtruesit nuk tregojnë se Zyra e Mbrojtjes ndryshoi qëndrimin e vet në lidhje me këtë.

47. Rrjedhimisht, duke u bazuar në ndryshimin e kërkesës fillestare, sikurse u komunikua përmes mesazhit elektronik të Zyrës së Mbrojtjes, Parashtruesi mund të nxirrte përfundimin e arsyeshëm se nuk ishte e nevojshme të dorëzonte një Formular të veçantë të Dhënies së Pëlqimit për llogarinë në [REDAKTIM] dhe se ishin të mjaftueshme gjendja aktuale në dy llogaritë bankare si dhe deklaratat bankare për këto llogari.

48. Rrjedhimisht, këto janë të vetmet dokumente të cilat duhej të dorëzonte Parashtruesi me qëllim që informacioni i dërguar prej tij të ishte “i vërtetë dhe i plotë me sa ka dijeni ai”, në përputhje me rregullën 5(3)(f) të RRPNJ-së dhe deklaratën e nënshkruar prej tij në lidhje me këtë.⁷³

⁷¹ Khs. Vendim në lidhje me ndihmën juridike f. 2; Përgjigjja e Administratores, para. 22, 24 (5 dhe 8 shkurt 2019); Dokumentet e Dorëzuara nga Administratorja të 28 shkurtit 2019, Shtojca konfidenciale 14, f. 6 (11 shkurt 2019); Shtojca konfidenciale 16, f. 3 (13 shkurt 2019); Shtojca konfidenciale 18, f. 5 (14 shkurt 2019).

⁷² Khs. para. 42 më lart.

⁷³ Dokumentet e Dorëzuara nga Administratorja të 28 shkurtit 2019, Shtojca konfidenciale 2, f. 57 (29 janar 2019).

(ii) Dokumentet e dorëzuara nga Parashtruesi

49. Pas sqarimeve të lartpërmendura, duhet përcaktuar nëse Parashtruesi dorëzoi “[informacion] të vërtetë dhe të plotë me sa ka dijeni [ai]” lidhur me dy llogaritë bankare, pra gjendjen aktuale dhe kopje të deklaratave bankare që prej 1 janarit 2018.

50. Në përgjigje të kërkesave të lartpërmendura të Zyrës së Mbrojtjes, Parashtruesi dorëzoi informacionin e mëposhtëm në lidhje me dy llogaritë bankare si vijon:

- a) deklarata bankare për llogarinë në [REDAKTIM] me numër [REDAKTIM] për periudhën e kërkuar ku tregoheshin tërheqje të kryera me kartelën bankare me numër: [REDAKTIM];⁷⁴ dhe
- b) deklarata bankare për llogarinë në [REDAKTIM] me numër: [REDAKTIM] për periudhën e kërkuar.⁷⁵

51. Në vijim, Parashtruesi dorëzoi, ndër të tjera, kopje të dy kartelave bankare të mëposhtme:

- a) kartelë bankare e [REDAKTIM] me numër: [REDAKTIM];⁷⁶ dhe
- b) kartelë bankare e [REDAKTIM] me numër: [REDAKTIM], për llogarinë bankare me numër: [REDAKTIM].⁷⁷

52. Sikurse është theksuar më herët,⁷⁸

⁷⁴ Parashtrimi i Administratores, Shtojca konfidenciale 12, f. 5 (11 shkurt 2019).

⁷⁵ Parashtrimi i Administratores, Shtojca konfidenciale 15, f. 7 (13 shkurt 2019).

⁷⁶ Parashtrimi i Administratores, Shtojca konfidenciale 19, f. 13, 15 (16 shkurt 2019).

⁷⁷ Parashtrimi i Administratores, Shtojca konfidenciale 19, f. 9, 11 (16 shkurt 2019).

⁷⁸ KSC-BC-2019-02, F00005, Gjykatësi i vetëm, *Urdhër për Administratoren për parashtrimin e përgjigjes*, 4 mars 2019, konfidencial, para 13-14.

- a) numri i kartelës së [REDAKTIM]⁷⁹ është i njëjtë me numrin e parë të shënuar në Formularin e Dhënies së Pëlqimit;⁸⁰ ndërsa deklaratat bankare të dorëzuara nuk tregojnë numrin e plotë të kartelës bankare,⁸¹ [REDAKTIM] ka ngjashmëri të konsiderueshme me numrin e shënuar në Formularin e Dhënies së Pëlqimit ([REDAKTIM]); ky fakt pranohet nga Administratorja;⁸²
- b) numri i kartelës së [REDAKTIM]⁸³ është i njëjtë me numrin e dytë të shënuar në Formularin e Dhënies së Pëlqimit;⁸⁴ gjithashtu, numri i llogarisë bankare në kartelën bankare⁸⁵ është i njëjtë me numrin e dhënë në deklaratat bankare përkatëse;⁸⁶ edhe ky fakt pranohet nga Administratorja.⁸⁷

53. Duke mbajtur parasysh informacionin e kërkuar nga Administratorja dhe dokumentacionin e dorëzuar nga Parashtruesi, ai faktikisht dorëzoi "[informacion] të vërtetë dhe të plotë me sa ka dijeni [ai]." Rrjedhimisht, përfundimi i Administratores se Parashtruesi nuk dorëzoi 'informacion të besueshëm dhe të faktuar' në lidhje me dy llogaritë bankare, nuk konfirmohet nga provat. Në nxjerrjen e këtij përfundimi, ajo nuk u kushtoi rëndësinë e duhur çështjeve përkatëse që iu dhanë për shqyrtim dhe nuk mori parasysh fakte thelbësore, gjegjësisht lidhjen e dukshme midis, nga njëra anë, 'numrave të llogarive' të shënuara në Formularin e Dhënies së Pëlqimit dhe, në anën tjetër, deklaratave bankare e kopjeve të kartelave bankare të dorëzuara më pas.

⁷⁹ Khs. para. 51 a) më lart.

⁸⁰ Khs. para. 42 më lart.

⁸¹ Khs. para. 50 a) më lart.

⁸² Përgjigja e Administratores, para. 39.

⁸³ Khs. para. 51 b) më lart.

⁸⁴ Khs. para. 42 më lart.

⁸⁵ Khs. para. 51 b) më lart.

⁸⁶ Khs. para. 50 b) më lart.

⁸⁷ Përgjigja e Administratores, para. 41.

54. Ndonëse vërehet se në lidhje me llogarinë në [REDAKTIM], deklaratat bankare nuk jepnin numrin e plotë të kartelës bankare, duhej të ishte marrë parasysh si duhet ngjashmëria midis numrit të shënuar në Formularin e Dhënies së Pëlqimit dhe numrit të kartelës të përfshirë në deklaratat bankare. Sa i përket llogarisë në [REDAKTIM], duke marrë parasysh se në kartelën bankare gjendet numri i kartelës si edhe numri i llogarisë bankare, duhej të ishte marrë parasysh se Parashtruesi kishte dorëzuar deklarata bankare që kishin të bënin me ‘numrin e llogarisë’ në [REDAKTIM], përmendur në Formularin e Dhënies së Pëlqimit.

55. Duke marrë parasysh se Parashtruesi kishte bërë të ditur gjendjen aktuale të dy llogarive bankare dhe kishte dorëzuar kopje të deklaratave bankare për dy llogaritë bankare që prej 1 janarit 2018, pra kishte dorëzuar “informacion të vërtetë dhe të plotë me sa ka dijeni ai”, përfundimi i Administratores se në lidhje me sa më sipër mungonte ‘informacion i besueshëm dhe i faktuar’, përbën gabim fakti.

(b) Vendim qartazi i paarsyeshëm

56. Pasi është konstatuar se Administratorja ka bërë gabim fakti, duhet përcaktuar nëse kjo rezultoi në një vendim qartazi të paarsyeshëm.

57. Është thelbësore të rikujtohen përgjegjësia dhe detyrimet e Administratores për të garantuar miradministrimin financiar të fondeve që i janë besuar asaj. Gjithashtu merret parasysh se llogaritë e Dhomave të Specializuara verifikohen dhe auditohen nga Komisioni Evropian, Zyra Evropiane Kundër Mashtrimeve dhe Gjykata Evropiane e Auditimit.⁸⁸ Është e kuptueshme se çdo informacion që jep Administratorja për këto verifikime duhet të jetë, për aq sa është e mundshme, i saktë, i plotë dhe jokontradiktor. Vetëm në këtë mënyrë Administratorja mund të garantojë përmbushjen e përgjegjësive që i janë besuar.

⁸⁸ Përgjigja e Administratores, para. 47, poshtëshënimi 46.

58. Në këtë kontekst, duhen marrë parasysh keqkuptimet e shkaktuara nga Parashtruesi kur shënoi në Formularin e Dhënies së Pëlqimit 'numrat e llogarive', të cilët faktikisht ishin 'numra të kartelave bankare'.⁸⁹ Për më tepër, çështja u ndërlíkua më tej kur Parashtruesi deklaroi më pas se numrat e llogarive të dy llogarive bankare ishin ndryshuar pa dijeninë e tij nga bankat përkatëse.⁹⁰

59. Në lidhje me sa më lart, Zyra e Mbrojtjes e informoi Parashtruesin se pa konfirmim nga bankat nuk mund të pranohej sqarimi i tij për ndryshimin e numrave të llogarive bankare.⁹¹ Dihet se ky konfirmim u kërkua për të kryer verifikimin e informacionit të dhënë nga Parashtruesi në mënyrë që të garantohej përmbushja prej Administratores e parimeve përkatëse të miradministrimit financiar.⁹²

60. Duke marrë parasysh ngjashmërinë midis numrave të kartelave bankare dhe numrave të llogarive bankare, deklarata vijuese e Parashtruesit në lidhje me një ndryshim të pretenduar të numrave të llogarive bankare duket se është *prima facie* e pasaktë. Parashtruesi, ose duhej ta kishte vërtetuar këtë deklaratë më tej, ose ta kishte korrigjuar, sikurse u kërkua nga Zyra e Mbrojtjes. Ai nuk e bëri këtë dhe shpjegimi i tij në lidhje me numrat mospërputhës të llogarive dhe kartelave bankare mbetet i pasqaruar.

61. Duke mbajtur parasysh detyrimet e Administratores për miradministrimin financiar të Dhomave të Specializuara dhe duke u bazuar në vlerësimin e tërësisë së informacionit të dhënë nga Parashtruesi, vendimi për refuzimin e ndihmës juridike duke u bazuar, ndër të tjera, në mungesën e sqarimeve të mëtejshme të deklaratës vijuese të Parashtruesit, nuk ishte qartazi i paarsyeshëm.

⁸⁹ Khs. para. 50-54 më lart.

⁹⁰ Dokumentet e Dorëzuara nga Administratorja të 28 shkurtit 2019, Shtojca konfidenciale 17, f. 7 (14 shkurtit 2019).

⁹¹ Dokumentet e Dorëzuara nga Administratorja të 28 shkurtit 2019, Shtojca konfidenciale 18, f. 5 (14 shkurt 2019).

⁹² Khs. Përgjigjja e Administratores, para. 51.

(c) Përfundim

62. Megjithëse Administratorja bëri gabim fakti në nxjerrjen e përfundimit se Parashtruesi nuk kishte dorëzuar informacion “të vërtetë dhe të plotë me sa ka dijeni [ai]” në lidhje me dy llogaritë bankare, ky gabim nuk pati si pasojë lëshimin e një vendimi qartazi të paarsyeshëm, duke marrë parasysh deklaratën vijuese të Parashtruesit e cila nuk u sqarua më tej, si edhe detyrimet e Administratores për miradministrimin financiar të fondeve që i janë besuar asaj.

63. Gjithsesi konstatohet se në të gjitha parashtrimet e saj Administratorja ka theksuar se ajo do ta rishikojë vendimin në lidhje me ndihmën juridike sipas rregullës 8(4) të RRPNJ-së pasi t’i jetë dorëzuar informacioni shtesë nga Parashtruesi.⁹³ Në parashtrimin e saj më të fundit, informacioni që duhet të dorëzohet Parashtruesi përcaktohet si më poshtë:

- a) tre formularë të veçantë të Dhënies së Pëlqimit për secilën llogari bankare në emër të Parashtruesit ku të shënohet numri i saktë i secilës llogari bankare; ose
- b) deklarata zyrtare nga:
 - i. [REDAKTIM], ku të shënohen të gjitha llogaritë bankare në emër të Parashtruesit në atë bankë dhe të shkruhet se numri [REDAKTIM] është faktikisht numri i kartelës bankare për një llogari bankare konkrete në emër të Parashtruesit në atë bankë; dhe
 - ii. [REDAKTIM], ku të shënohen të gjitha llogaritë bankare në emër të Parashtruesit në atë bankë dhe të shkruhet se numri

⁹³ Përgjigja e Administratores, para. 56-59; Parashtrimi i Administratores i 18 marsit 2019, para. 9-10.

[REDAKTIM] është faktikisht numri i kartelës bankare të një llogarie bankare konkrete në emër të Parashtruesit në atë bankë.⁹⁴

64. Po ashtu, Administratorja konfirmoi shprehimisht se deklarata të cilën ia kërkoi fillimisht Parashtruesit⁹⁵ ishte përmbushur në Kundërpërgjigjen e Parashtruesit.⁹⁶

V. KONFIDENCIALITETI

65. Meqenëse ky vendim cek thelbin e Dokumenteve të Dorëzuara nga Administratorja të 28 shkurtit 2019 dhe të Parashtrimit të Administratores të 18 marsit 2019, ai protokollohet konfidencialisht në bazë të rregullës 82(1)(b) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave deri në lëshimin e versionit publik të redaktuar.

VI. VENDIM

66. Duke u bazuar në sa më lart, gjykatësi i vetëm në vijim:

LË NË FUQI vendimin në lidhje me ndihmën juridike; dhe

VËREN se Administratorja do ta rishikojë vendimin në lidhje me ndihmën juridike në bazë të rregullës 8(4) të RRPNJ-së, pasi të marrë prej Parashtruesit dokumentet e përmendura në paragrafin 63 a), ose b).

⁹⁴ Parashtrimi i Administratores i 18 marsit 2019, para. 9-10, ku përmendet Përgjigjja e Administratores, para. 57 a)-c).

⁹⁵ Khs. Përgjigjja e Administratores, para. 57 d).

⁹⁶ Parashtrimi i Administratores i 18 marsit 2019, poshtëshënimi 13, ku përmendet Kundërpërgjigjja e Parashtruesit, para. 3-4.

/nëshkrim/
Gjykatës Nikola Giju
Gjykatës i vetëm

E hënë, 25 mars 2019
Në Hagë, Holandë.